

STATUTI

I SHOQËRISË TREGTARE "A.C.E Studio " Shpk

Shoqëria " A.C.E Studio "themelohet sot në datën 01.02.2021 në përputhje me Aktin e saj të Themelimit dhe përbëhet nga ortakët i mëposhtëm:

Argest Rushiti , me atësi Mane dhe amesi Lubjana , dtl. 12/06/1982 lindur ne Tepelene dhe banues,në Tiranë. Rruga " Liman Kaba "madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar

I.DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Shoqëria Tregtare " A.C.E Studio ", (shoqëri me përgjegjësi të kufizuar) rregullon pozitën e saj juridike, marrëdhëniet ndërmjet ortakëve, funksionimin dhe kompetencat e organeve të saj,llojin e shoqërisë , kohëzgjatjen e veprimtarisë se saj, marrëdhëniet me të punësuarit, duke u bazuar në ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", dhe dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e Shoqërive Tregtare.

NENI 1

Objekti i veprimtarise

1.1 Shoqëria ka si objekt veprimtaritë që vijojnë më poshtë:

Konsulencë tregtare dhe organizative në të gjitha format dhe në të gjithë sektorët e aktiviteteve brenda dhe jashtë vendit; projektim dhe realizim të programeve formuese dhe të zhvillimit të burimeve njerëzore; promovimi i aktiviteteve me karakter publicitar; projektimi dhe realizimi i fushatave publicitare dhe promovuese nëpërmjet shfrytëzimit të të gjitha instrumentave, përfshirë marketingun telefonik dhe instrumentave të tjera të marketingut të drejtperdrejte; shërbime marketingu brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nepermjet telefonit dhe internetit; projektimi dhe realizimi i fushatave publicitare dhe promovuese nepermjet shfrytëzimit të të gjitha instrumentave, përfshirë marketingun telefonik dhe instrumenta të tjera të marketingut nepermjet internetit;

1.2 Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çfarëdolloj veprimtarie tjetër të lejuar nga ligji dhe në përputhje me rregullat në fuqi.



NENI 2
Emri dhe selia e Shoqërisë

Shoqëria është Person Juridik Privat.

Shoqëria do të paraqitet në qarkullimin tregtar me emërtimin e saj "A.C.E Studio" (shoqëri me përgjegjësi të kufizuar).

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Rruga "Muhamet Gjollësia, Hyrja 2, Ap 5, Ring Center, Tiranë.

Shoqëria tregtare "A.C.E Studio" mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 3
Kohezgjatja e Shoqërisë

3.1 Shoqëria do të ketë një kohezgjatje të pakufizuar.

NENI 4
Regjimi Juridik i Shoqërisë

4.1 Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut dhe ka për qëllim fitimin. Ajo respekton parimin e reciprocitetit.

Ajo është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k.). Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit, si dhe dispozitave të legjislacionit tregtar e atij civil në fuqi. Me vendim të Asamblesë së Ortakëve (Ortaku i Vetëm), Shoqëria mundet që të ndryshojë regjimin juridik të saj në përputhje me dispozitat ligjore që do të jenë në fuqi, si dhe në përputhje të plotë me dispozitat e Aktit të Themelimit dhe të Statutit të saj, duke bërë edhe përshtatjen e tyre sipas ndryshimeve përkatëse.

4.2 Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

II. TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKUT

NENI 5

5.1 Pasuritë e krijuara nga Shoqëria gjatë aktivitetit të saj janë në pronësi të Shoqërisë. Ato (pasuritë) mund të tjetërsohen, të jepen me qira, me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme (Ortakut të vetëm)

NENI 6
Të drejtat dhe detyrimet e Ortakut të Vetëm

6.1 Ortaku i Vetëm jep kontributin e tij në shoqëri në para apo në natyrë, sipas mënyrave dhe afateve të përcaktuara në statut, në të cilën është caktuar në mënyrë të detajuar kontributi



dhe mënyra e afatet e derdhjes se ketij kontributi në këtë shoqëri. Ortaku i Vetem përgjigjet ndaj shoqërisë personalisht dhe ne mënyrë solidare për dëmet e shkaktuara nga mospërbushja e këtyre detyrimeve apo nga përbushja e tyre përtej afateve përkatëse. .Ortaku i Vetem mban përgjegjësi për humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

6.2 Personat pergjegjes per administrimin e shoqerise informojne Ortakun e Vetem per ecurine e veprimtarise se shoqerise tregtare dhe, me kerkesen e tij, duhet t'i vihen ne dispozicion llogarite vjetore, perfshire llogarite e konsoliduara, raportet per gjendjen dhe ecurine e veprimtarise se shoqerise tregtare, raportet e organeve drejtuese apo te eksperteve kontabel te autorizuar, si dhe cdo dokument tjetër te brendshem te shoqerise.

6.3 Personat pergjegjes per administrimin e shoqerise informojne Ortakun e Vetem per periudha nje mujore dhe tremujore per ecurine e shoqerise, realizimin e objektivave mujore dhe tremujore, llogarite, raportet per gjendjen dhe ecurine e veprimtarise se shoqerise tregtare me partneret nenkontraktore, raportet e organeve drejtuese apo te eksperteve kontabel te autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër te brendshem te shoqerise.

Gjatë ushtrimit të të drejtave, Ortaku i Vetëm vepron duke marrë parasysh interesat e shoqërisë. Ortaku i Vetëm respekton detyrimet që burojnë nga Akti i Themelimit dhe Statuti. Ai përpiqet për zhvillimin e aktivitetit të Shoqërisë sipas objektit të veprimtarisë së saj.

KUSHTET EKONOMIKE TË SHOQËRISË

NENI 7

7.1 Veprimtaria e funksionimit te Shoqerise bazohet ne kerkesat e ekonomise se tregut. Veprimtaria ekonomike ndertohet mbi parimet e llogarise dhe pasqyrohet ne bilancet e saj



NENI 8

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqerise eshte perbere nga kontributi ne para i Ortakut te Vetem ne vleren 10.000 (dhjete mije) leke.

Ortaku i Vetem i Shoqerise, zoteron nje kuote me vlere 10.000 leke (dhjete mije leke), e cila perben 100 % te kapitalit te regjistruar te shoqerise.

Kontributet qe perbejne 100% te kapitalit te regjistruar te shoqerise jane shlyer teresisht nga Ortaku i Vetem.

Ortaku i Vetem, ne baze te kerkeses se organit administrues, mund te sjelle para ne shoqeri. Kjo derdhje parash mund te behet ne formen e zmadhimit te kapitalit ashtu si dhe ne formen e financimit te shoqerise. Ne rastin e financimit te shoqerise nga Ortaku i Vetem ne forme huaje, nuk eshte e nevojshme te respektohet perpjesetueshmëria mes shumës së derdhur në shoqëri dhe kuotave të kapitalit që Ortaku i Vetem zotëron.

NENI 9

Pasuria e Shoqërisë

9.1 Shoqeria behet pronare e pasurise se luajtshme e te paluajtshme kur vlera e pasurise mbulohet teresisht ne te holla.

NENI 10

Transferimi i kuotave

10.1 Ortaku i Vetem i Shoqerise ka te drejten te transferojne lirisht kuotën qe zoterojne ne kapitalin e regjistruar te shoqerise, kundrejt pageses se nje shume;

10.2 Ortaku i Vetem i Shoqerise ka te drejte te heqe dorë nga Shoqeria dhe mund te shese kuotën nepermjet nenshkrimit te kontrates se shitjes se kuotes, pa qene nevoja e marrjes se nje vendimi paraprak nga Ortaku i Vetem i Shoqerise ne perputhje me kushtet qe i lejon Statuti dhe Ligji. Heqja dorë nga shoqeria nuk e liron ate nga detyrimet qe ka deri ne momentin e heqjes dorë dhe nuk e cenon ate ne marrjen e te ardhurave qe Shoqeria ka siguruar deri ne kete moment.

10.3 Kuotat e kapitalit mund te transferohen ne menyre te lire permes dhurimit apo cdo akti tjetër, falas.

NENI 11

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

11.1 Kapitali i regjistruar i shoqerise mund te zmadhohet ose te zvogelohet nga Asambleja e Pergjithshme (Ortaku i Vetem).



11.2 Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e Shoqërisë duke u vendosur rritja e vlerës së kuotes së Ortakut të Vetëm.

Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i Vetem) vendos për zvogelimin e kapitalit të Shoqërisë.

11.3 Zvogelimi i kapitalit nuk duhet të dëmtojë kreditorët dhe as të krijojë pasiguri tek ata që kanë dhënë kredi para publikimit të zvogëlimit të kapitalit. Në të kundert, Gjykata e konsideron të pavlefshëm këtë vendim mbi kërkesën e kreditorëve.

NENI 12 **Fondet rezerve**

12.1 Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera financimi për të përballuar nevojat e saj.

NENI 13 **Bilanci**

13.1 Pasuria e Shoqërisë vlerësohet në bilancet e saj në monedhe të vendit ose në monedhe të huaj sipas vlerësimit të Ortakut të Vetem ose eksperteve në momentin e themelimit të Shoqërisë.

Bilanci vjetor paraqitet brenda datës 31 Mars, të vitit pasardhës. Forma e bilancit përcaktohet nga Administratori në harmoni me format e bilanceve të vendosura në Republikën e Shqipërisë.

NENI 14 **Plani Financiar**

14.1 Plani financiar parashikon aktivin e pasivin e aktivitetit ekonomik të Shoqërisë, të shprehur në leke ose valute të konvertueshme. Llogaria ekonomike do të mbahet në Shqipëri. Shkembimi i monedhës shqiptare me atë të huaj dhe anasjelltas bëhet sipas kursit zyrtar ose privat të këmbimit.

NENI 15 **Shpërndarja e fitimit, kufizimi i shpërndarjes**

E ardhura neto që rezultojnë pasi zbriten shpenzimet e bera për kryerjen e çdo lloji aktiviteti nga zbritja e vlerës së amortizimit, nga tatimet dhe taksat, nga kuotat që rritin kredinë për investime, pagat dhe shpërblimet, përdoret nga Ortaku i Vetem, sipas qëllimeve të tij. Ortaku i Vetem ka të drejtë të marrë pjesën e fitimit tip deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë..

Shoqëria mund të shpërndajë fitime, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:



- a) aktivet e shoqërisë mbulojnë teresisht detyrimet e saj;
- b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që behen të kerkueshme brenda 12 muajve në vazhdim

ORGANET E SHOQËRISE

NENI 16 Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i Vetem)

16.1 Organi themelor i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme merr vendime për:

përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
ndryshimet e statutit;

emërimin e shkarkimin e administratorëve;

emërimin e shkarkimin e likujduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likujduesit dhe ekspertët kontabël të Autorizuar;

Mbikëqyrjen dhe zbatimin të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e Pasqyrave financiare mujore, tremujore e vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë: përcakton tagret e përfaqësimit të administratorëve në kushtet e nënshkrimit të kontratave të bashkëpunimit me shoqëri apo individë, kontratave të sipërmarrjes apo të shitjes, si dhe miraton kontratat tip që do të nënshkruhen.

Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit:

pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

çështje të tjera të parashikuara nga ligji,

NENI 17 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme mbledhet sa here që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mbledhet të pakten një here në vit. Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratorët apo Ortaku i Vetem

Vendimet e marra nga Ortaku i Vetem, së bashku me procesverbalin e mbledhjes dhe aktet e tjera që i bashkëlidhen sipas këtij proceverbalit, regjistrohen në librin e shoqërisë



NENI 18

Procesverbali i mbledhjes së Asamblesë

18.1 Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet te rregjistrohen ne procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme.

18.2 Procesverbali duhet të përbaje datën dhe vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e te mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

18.3 Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme.

18.4 Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 19

19.1 Asambleja e Përgjithshme emeron një ose më shumë persona fizikë ,si administratore te shoqërisë. Afati i emërimit, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Statuti mund të vendosë rregulla të posaçme për emërimin e administratorëve.

Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie,të kontrolluar e anasjelltas.

19.2 Mund të emërohen si administratorë të shoqërisë edhe personat fizikë që nuk janë Ortakë.

19.3 Emërimi i Administratorëve bëhet me unanimitet nga Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i Vetëm).

NENI 20

Të drejtat dhe detyrimet e administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

-kryejnë të gjith veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i Vetëm);

-përfaqësojnë shoqërinë tregtare;



- kujdesen per mbajtjen e saktë e të rrëgullt të dokumenteve dhe te librave kontabël të shoqërisë;
 - përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku më propozimin per shperndarjen e fitimeve,i paraqesin këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme (Ortaku i Vetëm) për miratim;
 - krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, sic parashikohet në ligjin "Tër regjistrimin e biznesit";
 - raportojnë përpara Asamblesë së Përgjithshme (Ortaku i Vetëm) në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rëndësi ,të vecantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme (Ortaku i Vetëm) kur shoqëria brenda 2 viteve të para te regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kane vlerë më të larte se 5 për qind të aseteve te shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara dhe kur sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
 - të bëjnë pagesa pa miratimin e Asamblesë se Përgjithshme (Ortaku i Vetëm)
 - te depozitoje e terheqe fonde nga llogarite bankare sipas nevojave te shoqerise
 - të bëjnë pagesat qe i detyrohet subjektit ndërtues dhe nënkontraktorëve, konform situacionit të punimeve të paraqitur e të miratuar nga eksperti kontabël.
 - të nënshkruajnë kontratat e sipërmarrjes, të bashkëpunimit apo paraprakë të shitjes per objektet që janë në ndërtim e sipër, sipas çmimeve paraprake të miratuara nga Ortaku i Vetëm për çdo komponent të ndërtimit të ri.
- 20.2 Perveç detyrave të treguara më lart për çdo veprim tjetër administratori/ët duhet të marrë më parë miratimin e Asamblesë së Përgjithshme (Ortaku i Vetem).

Nese Asambleja e Pergjithshme (ortaku i Vetem) emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine. Statuti ose rregulloret e tjera, te miratuara nga Asambleja e Pergjithshme (Ortaku i Vetem), mund te parashikojné ndryshe.

Asambleja e Përgjithshme,(Ortaku i Vetëm) mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përashtojné apo kufizojné këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 21

Shpërblimi i administratorëve

Shpërblimet e administratorëve përcaktohen me vendim të Asamblesë së Pergjithshme (Ortaku i Vetëm).



Shpërblimi duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë.

Nëse shoqëria është në veshtirësi financiare, Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i Vetëm) mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorëve në masën e përshtatshme. Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorëve në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore. Administrator i Shoqërisë " A.C.E Studio "do të jetë Z.Argest Rushiti.

NENI 22

Ekspertët Kontabël

22.1 Shoqëria cakton ekspert kontabel për çdo vit financiar kur jemi përpara rasteve të percaktuara në ligj. Emerimin e tyre e ben Mbledhja e Asamblese se Përgjithshme (Ortaku i Vetëm).

Ekspertët kontabël mbajnë përgjegjësi për mbajtjen e rregullt të të gjithë dokumentacionit të Shoqërisë. Ata përgjigjen për dëmet që i vijnë Shoqërisë nga mbajtja e parregullt e llogarive ose verifikimi i tyre i gabuar.

Nuk mund të ngarkohen me detyrën e ekspertit, themeluesi, administratori, personat që janë gjini e krushqi me ata deri në shkallën e katërt.

NENI 23

Marredheniet e punes

23.1 Marredheniet e punes në Shoqëri rregullohen sipas dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit dhe Legjislacionit Shqiptar të Punes.

Punesimi në Shoqëri realizohet me anë të kontrates individuale të punes midis Shoqërisë e të punësuarve. Marredheniet midis Shoqërisë e sindikates rregullohen nëpërmjet kontrates kolektive të punes.

NENI 24

24.1 .Te punësuarit dhe punonjësit drejtues administrativ janë përgjegjës për dëmet që i shkaktojnë Shoqërisë për faj të tyre dhe përgjigjen para saj civilisht.



PRISHJA E SHOQËRISË. LIKUJDIMI

NENI 25

25.1 Kjo Shoqëri do të prishet në rast se:
me vendimin të Asamblesë së Përgjithshme (Ortaku i Vetëm):
me hapjen e procedurave të falimentimit;
nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nëse është pezullimi i
veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit",
i ndryshuar;
me vendim të gjykatës;
për arsye të tjera, të parashikuara në statut;
Prishja e shoqërisë regjistrohet në Regjistr i Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit
nga administratorët.

NENI 26

Likuidimi i shoqërisë

26.1 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Asambleja e Përgjithshme.

Nëse Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i vetëm) likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, për të caktuar një likuidues.

DISPOZITA TË FUNDIT

NENI 27

27.1 Ky Statut hyn në fuqi pas miratimit dhe regjistrimit të Shoqërisë në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.



NENI 28

28.1 Gjithcka nuk eshte parashikuar shprehimisht në këtë Statut do te disjplinohet sipas legjislacioni tregtar dhe ligjeve te tjera të lidhura me te , ne fuqi ne Republikën e Shqipërisë.

NENI 29

29.1 Ky Statut perpilohet në 5(pese) kopje në gjuhën shqipe, dhe u nënshkrua pa verejtje nga ortaku themelues.

ORTAKU THEMELUES

—
Argjesh Rushiti


AKT THEMELIMI
|
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR

“ A.C.E Studio ” SHPK

Ortaku i vetem i Shoqërisë Argëst Rushiti , me atësi Mane dhe amësi Lubjana , dtl 12/06/1982 , lindur ne Tepelene dhe banues në Tiranë rruga “ Liman Kaba”, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar,bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 131/20 I5 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”. Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007. “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar. Mbledhur në Tiranë sot më datë 01/02/2021

i mbledhur në Tiranë sot më datë 01/02/2021

VENDOSI:

Të krijojë një shoqëri tregtare dhe për këtë qëllim të hartojë dhe miratojë këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon.

NENI 1

Emri

Shoqëria do të paraqitet në qarkullimin tregtar me emërtimin e saj **“A.C.E Studio”** sh.p.k. Ndryshimi i emrit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë (Ortaku i vetem).

NENI 2

Forma juridike

Shoqëria tregtare **“A.C.E Studio ”** shpk, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k).

Shoqëria mund të transformohet në një formë tjetër juridike me vendim të Asamblesë së Përgjithshme (Ortaku i Vetem) sipas përcaktimeve në ligj dhe në Statutin e saj.



NENI 3

Selia

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Rruga " Muhamet Gjollësia, Hyrja 2, Ap 5 ,Ring Center, Tiranë.

Ndryshimi i selise se shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë (Ortakut i Vetëm).

Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë (Ortakut i Vetëm) shoqëria mund të hapë degë të saj apo Zyra përfaqësuese në qytete të tjera apo dhe jashtë Shqipërisë.

NENI 4

Vula e Shoqërisë

Shoqëria do të ketë vulën e saj.

Forma e vulës dhe masa e saj do të përcaktohen nga Asambleja e Ortakëve (Ortakut i Vetëm) në përputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 5

Objekti i Veprimtarisë

Shoqëria ka si objekt veprimtaritë që vijojnë më poshtë:

Konsulencë tregtare dhe organizative në të gjitha format dhe në të gjithë sektorët e aktiviteteve brenda dhe jashtë vendit; projektim dhe realizim të programeve formuese dhe të zhvillimit të burimeve njerëzore; promovimi i aktiviteteve me karakter publicitar; projektimi dhe realizimi i fushatave publicitare dhe promovuese nëpërmjet shfrytëzimit të të gjitha instrumentave, përfshirë marketingun telefonik dhe instrumentave të tjera të marketingut të drejtperdrejte; shërbime marketingu brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nepermjet telefonit dhe internetit; projektimi dhe realizimi i fushatave publicitare dhe promovuese nepermjet shfrytëzimit të të gjitha instrumentave, përfshirë marketingun telefonik dhe instrumenta të tjera të marketingut nepermjet internetit;


Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çfarëdolloj veprimtarie tjetër të lejuar nga ligji dhe në përputhje me rregullat në fuqi.

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

6.1 Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje me një afat të pacaktuar.

6.2 Shoqëria ka personalitet juridik duke filluar nga momenti i regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.



NENI 7

Kapitali I shoqerise dhe kuotat

Kapitali i regjistruar i shoqerise eshte i perbere nga kontributi ne para i Ortakut te vetem ne vleren 10.000 leke.

Ortaku i Vetem i Shoqerise, zoteron nje kuote me vleren 10.000 leke (dhjete mije leke), e cila perben 100% te kapitalit te regjistruar te shoqerise.

Kontributet qe perbejne 100% te kapitalit te regjistruar te shoqerise jane shlyer teresisht nga Ortaku i Vetem.

Financimet ne forme huaje te bera nga ortaku do te konsiderohen si hua pa interes.

NENI 8

Organet e Shoqerise

Organet e drejtimit te shoqerise jane: Ansambleja e Pergjithshme (Ortaku i vetem).

Administratori

Kompetencat, te drejtat dhe detyrat e ketyre organeve do te percaktohen ne statutin e shoqerise

NENI 9

Te drejtat dhe detyrimet e ortakut te vetem

9.1Ortaku jep kontributin e tij ne shoqeri ne para apo ne natyre, sipas menyrove dhe afateve te percaktuara ne statut ne te cilen eshte percaktuar ne menyre te detajuar kontributi dhe menyra e afatet e derdhjes se ketij kontributi ne kete shoqeri. Ortaku i Vetem pergjigjet ndaj shoqerise personalisht dhe ne menyre solidare per demet e shkaktuara nga mospembushja e ketyre detyrimeve apo nga pambushja e tyre pertej afateve perkatese. Ortaku i Vetem mban pergjegjesi per humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara.

9.2Personat pergjegjes per administrimin e shoqerise informojne ortakun per ecurine e veprimtarise ,se shoqerise tregtare dhe me kerkesen e tij, duhet t'i vene ne dispozicion llogarite vjetore, perfshire llogarite e konsoliduara, raportet per gjendjen dhe ecurine e veprimtarise se shoqerise tregtare, raportet e organeve drejtuese apo te eksperteve kontabel te autorizuar, si dhe cdo dokument tjetër te brendshëm të shoqerise.

9.3 Personat pergjegjes per administrimin e shoqerise informojne Ortakun e Vetem per periudha njemujore dhe tremujore per ecurine e shoqerise, realizimin e objektivave mujore dhe tremujore. Llogarite, raportet per gjendjen dhe ecurine e veprimtarise se shoqerise tregtare me partneret nenkontraktore, raportet e organeve drejtuese apo te eksperteve kontabel te autorizuar, si dhe cdo dokument tjetër te brendshëm të shoqerise.



9.4 Ortaku i Vetëm i Shoqërisë ka të drejtë të heqi dorë nga Shoqëria dhe mund të shesi kuotën nëpërmjet nenshkrimit të kontrates së shitjes së kuotës, pa qenë nevoja e marrjes së një vendimi paraprak nga ortaku i Vetëm i Shoqërisë në përputhje me kushtet që i lejon Statuti dhe Ligji Heqja dorë nga shoqëria nuk e liron atë nga detyrimet që ka deri në momentin e heqjes dorë dhe nuk e çënon atë në marrjen e të ardhurave që Shoqëria ka siguruar deri në këtë moment.

9.5 Gjatë ushtrimit të të drejtave, Ortaku i Vetëm vepron duke marrë parasysh interesat e shoqërisë. Ortaku i Vetëm respekton detyrimet që burojnë nga Akti i Themelimit dhe Statuti. Ai përpiqet për zhvillimin e aktivitetit të Shoqërisë sipas objektit të veprimtarisë së saj.

NENI 10

Administratori

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Ansambleja e Përgjithshme (Ortaku i. vetëm). Afati i emerimit është 5 vjet me të drejtë riperseritje

Administrator i Shoqërisë është Z. Argest Rushiti , me atesi Mane dhe amesi Lubjana, dtl. 12/06/1982 lindur Tepelene, dhe banues në Tiranë. Rr. " Liman Kaba " madhor me zotesi të plote juridike dhe për të vepruar, identifikuar me nr ID. 034601200 dhe nr. Personal I20612025E .

10.3. Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i vetëm) mund të emërojë një administrator të dytë me vendim të saj.

NENI 11.

11.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj, në përputhje të plotë me Aktin e Themelimit, Statutin dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi. Për sa nuk parashikohet në Aktin e Themelimit dhe në Status do të zbatohen kryesisht dispozitat e ligjit «Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare» Kodit Civil dhe legjislacionit në fuqi.

NENI 12

12.1 Ky Akt themelimi përpilohet në 5 (pese) kopje identike në gjuhën shqipe dhe u nënshkrua pa vërejtje nga ortaku themelues.

ORTAKU THEMELUES

Argest Rushiti

[Signature]

[Signature]